



KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

Duke u bazuar në nenin 13, 58 dhe 34, të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale, Nr-03/L040, dispozitave të statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës në Suharekë me datë 16.02.2018, lidhë këtë :

Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi

në mes të

Shoqatës Bëmirëse “Jetimat e Ballkanit”

dhe

Komunës së Suharekës

26.04.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLICA OF KOSOVO - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRË NË DORËZIM - PRIMLJENO			
Numri Braj Org. Unit	Numri Braj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	016	24342	7

Neni 1

Objekt i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi lidhet në mes të Shoqatës Bëmirëse Jetimat e Ballkanit, të përfaqësuar nga **Berat Kabashi, Drejtor i përgjithshëm**, dhe Komunës së Suharekës, të përfaqësuar nga **Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës**, me qëllim të financimit të projektit të ndërtimit të 15 shtëpive.

Neni 2

Kushtet për formimin e kësaj marrëveshje

Kjo marrëveshje parasheh ndërtimin e 15 shtëpive , sipas formës me qelsa në dorë, për familjet me kushte të rënda ekonomike dhe të cilët nuk kanë kushtë minimale banimi. Komuna me qëllim të krijimit të kushtëve sa më të mira për familjet sociale, pranon dhe e përkrah lidhjen e kësaj marrëveshje.

Neni 3

Qëllimi i marrëveshjes

- 3.1 Komuna me qëllim të krijimit të kushtëve sa më të mira për familjet sociale, pranon dhe e përkrah lidhjen e kësaj marrëveshje.
- 3.2 Sh.B. “Jetimat e Ballkanit“ në mënyrë vullnetare, të pavarur dhe vullnetë plotë, obligohet dhe zotohet për sigurimin e materialit dhe ndërtimin e shtëpive të familjeve skamnore në formën qelsa në dorë.

Neni 4

Obligimet e Shoqatës

4.1 **Shoqata Jetimat e Ballkanit** është institucioni implementues i këtij projekti i cili parasheh periudhën e ndërtimit të shtëpive sipas programit qelsa në dorë.

4.2 Shoqata Bamirëse “Jetimat e Ballkanit“ janë të obliguar të raportojnë për përfundimin e ndërtimit të këtyre shtëpive.

Raportimi duhet të bëhet me shkrim para institucioneve të Komunës së Suharekës

Neni 5 Afati i Realizimit

Afati i realizimit të qëllimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit duhet të arrihet brenda vitit 2021

Neni 6 Obligimet e Palëve

6.1 Vlera e gjithëmbarshme e projektit të ndërtimit të Shtëpive është **262,500.00 Euro**.

6.2 Komuna e Suharekës, do të participoj shumë prej **45,000.00 Euro**.

6.3 Shoqata Bamirëse Jetimat e Ballkanit do të participojn vlerën tjetër deri në përfundimin e ndërtimit të shtëpive sipas formes qelsa në dorë.

Neni 7 Interpretimi dhe Ndryshimi

7.1 Interpretimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit do të bëhet në pajtim me ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.

7.2 Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga ana e dy palëve.

Neni 8 Zgjidhja e Marrëveshjes

Palët zotohen se do t'i përmbahen kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësie në tekstin e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim.

Neni 9 Shkëputja e Marrëveshjes

E drejta e shkëputjes së njëanshme të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit, do të bëhet në rastet e shkeljeve të obligimeve që janë të përcaktuar me këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit, duke e njoftuar palën tjetër 30 ditë para shkëputjes së Marrëveshjes.

Neni 10
Hyrja në Fuqi

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese.

PALET NË MARRËVESHJE



26 PRILL 20201
VBKomuna e Suharekës